

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim, datë 11.05.2026, depozituar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) në adresën elektronike info@dap.gov.al, nëpërmjet të cilës kërkonti informacion lidhur me nëpunësen civile znj. J. G., ju sqarojmë se:

Nga të dhënat e administruara pranë DAP-it, rezulton se është regjistruar fletë thirrja me nr. 9576 akti datë 24.07.2025 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet të cilës na është komunikuar kërkesëpadia juaj, si dhe jemi thërritur, në çështjen administrative me palë:

PADITËS: E. Gj.;

TË PADITUR: Ministria e Drejtësisë;

Departamenti i Administratës Publike;

OBJEKTI: 1. Kundërshtimin dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të vlerësimit të pjesshëm të punës datë 21.07.2024, të vendimit nr. 4039 për moskonfirmimin e statusit datë 22.07.2024, të vendimit nr. 26 për lirim nga shërbimi civil datë 30.07.2024.

2. Detyrimin e palës së paditur të paguajë pagat nga momenti i largimit (sipas përcaktimeve të vlerës saj në aktet përkatëse vkm nr. 421 dhe vkm nr. 436 datë 26.06.2024), deri në momentin e rikthimit duke përfshirë në të çdo shtesë eventuale që mund ti bëhet pagës deri në momentin e rikthimit duke përfshirë shtesat vjetore për vjetërsi pune për çdo vit deri në momentin e rikthimit, si dhe duke shtuar normën e inflacionit të përcaktuar nga Banka Kombëtare për çdo vit deri në momentin e rikthimit.

3. Detyrimin e DAP si i vetmi institucion i ngarkuar nga ligji për nxjerrjen e akteve të emërimit, të më rikthejë në pozicionin përkatës ose në një pozicion tjetër të barazvlefshëm me të për nga niveli i pagës.

Në faqen 3 të kërkesëpadisë së depozituar nga ana juaj, rezulton se lidhur me nëpunësen znj. J. G., ju shprehimisht keni pretenduar: *“Qasja e paligjshmërisë institucionale vazhdoi në vijimësi e pandërprerë, në fund të muajit nëntor 2023 marr informacion në mënyrë informale se më ishte caktuar si nëpunës mbikëqyrës në kundërshtim me ligjin specialistja më e re e sektorit, e cila ishte dhe me profil ekonomik...”*

Ndërkohë, në pikën 2, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, ndër të tjera përcaktohet se:

“2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
- ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
- d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
- dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor...

Për sa më sipër, referuar dispozitës ligjore të sipërcituar, gjendemi në kushtet e kufizimit të së drejtës për informim, në kushtet kur lidhur me sa kërkoni informacion, ju keni ngritur shprehimisht pretendime për paligjshmëri, në një proces gjyqësor ku keni paditur dhe DAP-in. Theksojmë se, pretendimet tuaja mund të trajtohen nga Gjykata respektive, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Si përfundim, ju informojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 12. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al